



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr. 516/22
Data/Datum. 05.12.2022

PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovo
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 516/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Znj. Kimete Gashi- Kryetare, Z. Agon Ramadani - Referues, Z. Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "VALDRINI SH.P.K" Drenas, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kolektorit në Hajvali", me nr. të prokurimit: 616-22-5630-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, me datën 25.11.2022 mori këtë:

V E N D I M

I APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "VALDRINI SH.P.K" Drenas, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 06.10.2022 me numër të protokollit 516/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i kolektorit në Hajvali", me nr. të prokurimit: 616-22-5630-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

II. ANULOHET Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 29.09.2022, Autoriteti Kontraktues – KK Prishtinë ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit ““Ndërtimi i kolektorit në Hajvali”, me nr. të prokurimit: 616-22-5630-5-1-1.

Me datën 03.10.2022, OE “VALDRINI SH.P.K” Drenas, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me vendim me datën 03.10.2022.

Me 06.10.2022 OE “VALDRINI SH.P.K” Drenas, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 516/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 14.10.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;

Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se: Udhëheqësi i punishtes i paraqitur me vendim Zenun Tolaj, nga dokumentacioni i prezantuar është i pa përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues- në bazë të dokumentacionit të ofruar për inxhinierin Z.Zenun Tolaj nuk e konteston përvojën e punës 8 vite përvojë pune pas diplomimit, mirëpo operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të ofroj dëshmi që udhëheqësi i punishtes të ketë udhëhequr së paku një kontratë në vlerën e parashikuar, andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

OE ankues pretendon se: Inxhinieri i Hidros Shkelzen Rexha, nuk e plotëson CV ashtu siç është kërkuar në dosje dhe i mungon përvoja pasi që në CV-në e plotësuar ka dyshime duke mos e paraqit fillimin dhe mbarimin.

Eksperti shqyrtues, sqaron se lidhur me CV për këtë inxhinier është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit, për faktin se nuk është kërkuar ndonjë specifikë e veçantë që të përshkruhet në CV, por është kërkuar CV dhe e njëjta është ofruar, andaj pretendimi i OE ankues lidhur me CV e inxhinierit të Hidroteknikës është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

OE ankues thotë se: Në dosje të tenderit Neni 9.1&9.2 është kërkuar së paku dy teknik të ndërtimitarisë 2 vite përvojë pune pas diplomimit. Në ofertë janë prezantuar vetëm lista e stafit ku figurojnë punëtorët teknik, por asnjë dëshmi për diplomë, përvojën e kryer, referenca për punët e ngjashme dhe CV.

Teknikët e ndërtimitarisë nga ana e OE i rekomanduar për kontratë janë ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon se: Në dosje të tenderit Neni 9.1&9.2 është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ofroj 2 Saldues të certifikuar EN ISO 9606-1 2012.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se në listën e punëtorëve për përmbushjen e kësaj kërkesë të dosjes së tenderit, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar dy saldues, për të cilët është ofruar kontratat e punës me orar të plotë. Gjithashtu, për saldues janë ofruar edhe Certifikatë nga qendra e aftësimit profesional (Ministria e punës dhe mirëqenies Sociale-Agjencia e punësimit e RKS-së).

Eksperti shqyrtues, sqaron se CV-ja për saldues nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Lidhur me kontratat e punës për saldues, është evident fakti se kontratat nuk kanë datë të fillimit dhe mbarimit të kontratës.

Ndërsa lidhur me certifikatën EN ISO 9606-1 2012, në dokumentet e ofruar nuk është gjendur një certifikatë e tillë, andaj eksperti shqyrtues, vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshminë (certifikatën EN ISO 9606-1 2012) për saldues konform kërkesës së dosjes së tenderit, rrjedhimisht pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë po ashtu sqaron:

Lidhur me pretendimin e parw ankimor të OE ankues i cili pretendon se OE i rekomanduar ka paraqitur udhëheqësin e punishtes Zenun Tolaj duke pretenduar se udhëheqësi i punishtës nuk ka mbikqyrur një kontratë në vlerën e parashikuar, PSH vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues wshtw i bazuar sepse tek lista e kontratave të cilat janë prezentuar në emër të udhëheqësit të punishtës nga OE i rekomanduar nuk është paraqitur asnjë kontratë nw vlerwn e kwrkuar dhe e cila plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. PSH shqyrtoj të gjitha shkresat dhe konstatoj se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kwrkesat sipas dosjes së tenderit andaj konsiderohet se OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pwr kwtw aktivitet tw prokurimit.

PSH lidhur me pretendimet ankimore 2 dhe pretendimit nr. 3 të parashtruara nga OE ankues ia falë besimin përgjigjes së dhënë në raportin e ekspertit, duke i cilësuar si pretendime të pabazuara

Lidhur me pretendimin ankimor 4. në të cilin OE ankues pretendon se në dosje të tenderit Neni 9.1&9.2 është kërkuar që duhet të ofrojnë 2 Saldues të certifikuar EN ISO 9606-1 2012. PSH konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK gjatë vlerësimit ka qenë dashur të kërkoj sqarime/plotësime shtesë sipas nenit 72 të LPP-sw mirwpo pasi PSH konstatoi si pwr gjigjen e pretendimin tw parw konsideron se plotësimet e dokumentacioneve/ certifikatat për saldues janë të panevojshme nga ana e AK.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, mbetet si në dispozitiv të këtij vendimi duke aprovuar ankesën si të bazuar nga ana e OE Ankues njëherit duke kthyer në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesuese e Panelit të Shqyrtues

Kimete Gashi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinë;

1x1 OE- "VALDRINI SH.P.K" Drenas;

1x1 Arkivës së OSHP-së;